

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO
 QEVERIA-VLADA-GOVERNMENT
 MINISTRIA E PUNËS DHE MIRËQENIES SOCIALE
 Ministarstvo Rada i Socijalne Zastite-Ministry of Labour and Social Welfare
 Agjencioni Inspektoratit të Punës
 Izvršna Agencija Inspektorata Rade-Agency of Inspectorate of Labour
 Njësia Org. IP
 Org. Jedinica
 Org. Unit
 Nr. i faqeve
 Br. stranica
 No. pages
 Nr. Prot.
 Broj Prot.
 Prot. No. 1002
 Data:
 Datum: 15. 06. 2022
 Date:
 Prishtinë-Prishtine Prishtina



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVA

QEVERIA E KOSOVËS / VLADA KOSOVA / GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve - Ministarstvo Finansija, Rada i Trasfera -
 Ministry of Finance, Labour and Transfers
 INSPEKTORATI I PUNËS

Në mbështetje të nenit 4 të Ligjit nr. 2002/9 dhe nr.03/L-017 për Inspektoratin e Punës në Kosovë, Kryeinspektori i Inspektoratit të Punës, nxjerr këtë:

PLOTËSIM NDRYSHIM TË PLANIT TË PUNËS PËR VITIN- 2022

Me këtë plan të punës parashihen inspektimet nga lëmit e marrëdhënies së punës, sigurisë dhe shëndetit në punë në kuadër të autorizimeve që burojnë nga Ligji mbi Inspektoratin e Punës dhe ligjeve tjera përkatëse të cilat rregullojnë të drejtat e punonjësve mbikëqyrja e të cilëve bie në kompetencë të Inspektoratit të Punës.

Me këtë plan të punës Inspektorati i Punës synon të kontribojë në zhvillimin e baraspeshuar ekonomiko-social dhe prosperitetin e vendit duke ofruar shërbime inspektive të punës të drejta dhe të paanshme, të efektshme dhe efikase, që do të garantojnë zbatueshmërinë e ligjeve, rrisin sigurinë, mbrojnë shëndetin e punëtorëve në vendet e tyre të punës dhe ndikojnë në krijimin e kushteve të zhvillimit të veprimtarisë së subjekteve punuese të barabarta duke ndikuar që të zhvillohet konkurrencë e shëndoshë ndërmjet tyre në ushtrimin e veprimtarisë së punës si dhe synohet mbikëqyrja efektive e zbatimit të dispozitave të ligjit dhe akteve nënligjore, duke zhvilluar procesin e inspektimit në marrëdhëniet e punës, sigurisë dhe shëndetit në punë, në secilin subjekt punues, qoftë ai të jetë person juridik ose person fizik dhe duke e inspektuar secilin vend të punës brenda këtyre subjekteve të inspektuara. Nëpërmjet inspektimeve të tilla synojmë të garantojmë realizimin më të mirë të të drejtave të punëtorëve që burojnë nga marrëdhënia e punës, siguri më të madhe në vendet e punës, dhe shëndet më të mirë të punëtorëve.

Objektivat kryesore të cilat synohen të arrihen përmes këtij plani të punës janë:

1. Zvogëlimi i punës së padeklaruar në punë për 5% dhe numrit të personave të angazhuar në punë në kundërshtim me ligjet në fuqi,
2. Krijimi i kushteve të përshtatshme dhe të shëndetshme për punë, parakushtë për zvoglimin e aksidenteve në vendet e punës.

3. Zbatimi i Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligjit Nr.05/L-078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin dhe Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, konform vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.08/46 datë 30.11.2021.

Veprimet për realizimin e objektivave kryesore të planit të punës për vitin 2022 janë:

1. Rritja e numrit të Inspektorëve të punës;
2. Ngritja e kualitetit të inspektimeve duke realizuar inspektime më përmbajtësore dhe më gjithëpërfshirëse, si dhe përmes rritjes së numrit të inspektimeve për 10% deri në fund të vitit 2022.
3. Mbajtja e trajnimeve për inspektorët e punës lidhur me mbikëqyrjen e dispozitave pozitive ligjore që rregullojnë, sigurinë dhe shëndetin në punë të cilat dalin nga transpozimi i direktivave individuale të KE.

Inspektimet e pa planifikuara në këtë plan të punës si: ankesat e palëve, aksidentet në vendin e punës dhe inspektimet në bashkëpunim me organet tjera, do të inkorporohen në këtë plan të punës.

Ky plan i punës mundë të ndryshohet dhe të plotësohet për shkak specifikës së ushtrimit të detyrës së Inspektorit të Punës nëse Kryeinspektori i Punës e vlerëson të nevojshëm.

Udhëheqësit e Divizioneve të Koordinimeve të Rajoneve përkatëse do të hartojnë plan të veprimit për realizimin e këtyre objektivave do të udhëzojnë Inspektorët e Punës ti përmbahen prioritetëve të inspektimeve për çdo muaj si në vijim:

MUAJI JANAR

Vlersimi i përformacës për punëtorët e IP-së për vitin 2021

Hartimi i raporteve javore, raportit mujor dhe raportit vjetor 2021

Të inspektohen :

Sektorët e prodhimit dhe shërbyese;

MUAJI SHKURT

Të inspektohen

Veprimtaria shërbyese:

Spitalet, klinikat, Ordinancat Private shëndetësore, barnatoret shëndetësore, laboratorët mjekësor etj

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor;

MUAJI MARS

Të inspektohen

Veprimtarit zejtare, veprimtarit tregtare, dhe shërbyese;

Furrat e bukës, mishtoret, taksitë, transportuesit publik dhe privat të udhëtarëve dhe mallrave, floktarit, pastiqeritë, callcenter etj.

Inspektime në bashkëpunim me institucionet tjera (PK, ATK , etj.) Lokale të natës, Lokale për masazhe etj.

Hartimi i raporteve javore, raportit mujor dhe tremujor;

MUAJI PRILL

Të inspektohen

Veprimtaritë ndërtimore, energjetike dhe shërbyese:

Ndërtim i vrazhdë, suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të brendshme-ujësjellës, kanalizime, montues te pllakave, shtrim i dyshemesë , nxehjes qendrore etj.

Kompanitë e Sigurimeve fizike dhe të mirëmbajtjes së objekteve

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor

MUAJI MAJ

Të inspektohen

Veprimtarit ndërtimore, shërbyese, dhe bujqësore;

Ndërtim i vrazhdë, suvatim , fasadës, ekzekutim i punëve të brendshme ujësjellës, kanalizime, montues te pllakave, shtrim i dyshemesë, nxehjes qendrore, Gastronomia-hotelet, kafi terit, restaurantet, kultivuesit e pemëve e perimeve,lulishteve,përpunuesit e frutave dhe perimeve etj)

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor,

MUAJI QERSHOR

Të inspektohen

Veprimtaritë ndërtimore,minierat sipërfaqësore,subjektet metalurgjike,veprimtarit prodhuese dhe shërbyese.

Ndërtim i vrazhdë ,suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të brendshme, gurëthyesit prodhuesit e betonit dhe materialeve tjera përcjellëse, prodhuesit e asfaltit .

Hartimi i raporteve javore,raportit mujor dhe gjashtëmujor,

MUAJI KORRIK

Të inspektohen

Veprimtaritë ndërtimore, shërbyese dhe tregtare;

(Ndërtim i vrazhdë, suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të mbrendshme,

Marke tët, super marke tët qendrat tregtare,

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor

MUAJI GUSHT

Të inspektohen

Veprimtarit ndërtimore, prodhuese, veprimtarit informative publike dhe private te shkruara dhe elektronike

Ndërtim i vrazhdë, suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të brendshme, Radio televizionet publike dhe private, portalet informative, subjektet prodhuese.

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor,

MUAJI SHTATOR

Të inspektohen

Veprimtarit ndërtimore, shërbyese, tregtare;

Ndërtim i vrazhdë, suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të mbrendshme, institucionet bankare, Institucionet financiare, agjensionet turistike, subjektet tregtare,

Hartimi i raporteve javore, raportit mujor, dhe nëntmujor.

MUAJI TETOR

Të inspektohen

Veprimtarit ndërtimore, arsimore, sektori privat dhe publik

Ndërtim i vrazhdë, suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të mbrendshme,

Kolegjet, Institucionet arsimore në sektorin privat dhe publik,

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor;

MUAJI NËNTOR

Të inspektohen

Veprimtarit ndërtimore, shërbyese,

Ndërtim i vrazhdë, suvatim, fasadës, ekzekutim i punëve të mbrendshme

Serviset e automjeteve, auto lëmar, auto pjesë, zyrat për shërbime profesionale,

projektuese, zyrat e kontabilitetit, përmbaruesit privat, avokaturat, noterit)

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor;

MUAJI DHJETOR

Të inspektohen

Veprimtarit shërbyese:

Ngrohoret e qyteteve, KRU Regjionale, Kompanitë publike dhe private të pastrimit.

Planin e punës për vitin 2023

Hartimi i raporteve javore dhe raportit mujor;

Kryeinspektori i Punës, varësisht nga përmbushja e këtij plani të punës, do ti përcaktoj angazhimet shtesë sipas nevojës për këtë periudhë.

PRIORITETET:

Inspektorët e Punës gjatë realizimit të këtij plani të punës duhet ti japin prioritet Inspektimeve në veprimtarit me rrezikshmëri të lartë si në ndërtimtari, prodhimtari, tregtare, shërbyese dhe bujqësore me qëllim të krijimit të kushteve të sigurta dhe të shëndetshme për punë me synim parandalimin e aksidenteve në vendin e punës, inspektime për të zvogëluar punën e padeklaruar, shqyrtimit të ankesave të punonjësve, si dhe Zbatimi i Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin, Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, Ligjit Nr.05/L-078 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-019 për Aftësimin dhe Riaftësimin Profesional dhe Punësimin e Personave me Aftësi të Kufizuara, konform vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.08/46 datë 30.11.2021.

AKTIVITETET TJERA:

Inspektorët e Punës duhet të evidentojnë, të konstatojnë, shkaqet e përsëritjes së shkeljeve të dispozita ligjore në subjektet të cilat ushtrojnë veprimtari të njëjtë dhe të propozojnë masa të cilat kishin me ndikuar në zvogëlimin e shkeljeve të kësaj natyre. Udhëheqësit e Divizioneve të Koordinimeve të Rajoneve përkatëse do të analizojnë shkaqet dhe propozimet e konstatuara nga Inspektorët e Punës, dhe në bazë të tyre do ti propozojnë Kryeinspektorit të Punës që të njëjtat të merren në konsiderim gjatë hartimit të Planit të Punës për vitin 2023.

Datë 14.06.2022

Hekuran Nikçi
Kryeinspektor i Inspektoratit të Punës

